



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 6 Prot

Tiranë, më 07.03 2011

VENDIM Nr. 1 dt. 07.03.2011

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 07.03.2011, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

1. Lidhur me diskutimin e projekteve:

1. **Miratohet:** Projekt për restaurimin, rigjallërimin dhe rivlerësimin e kalasë së periudhës mesjetare në Lezhë. (Pas plotësimit të vërejtjeve nga KKR 22.12.2010).
2. **Lidhur me:** Projekti i restaurimit dhe rijetëzimit të objektit "Kafja e Madhe", Shkodër. Të plotësohet projekti me detajet:
 - Të përcaktohet kalimi i tubave shkarkues të ujërave të zeza.
 - Të përcaktohet teknologjia e ndërhyrjeve dhe përqindjet e ndërhyrjeve në katin e parë si dhe detajet që do të ruhen dhe detajet që nuk do të ruhen, duke argumentuar mosruajtjen e tyre. Pas plotësimit të vërejtjeve projekti tu përcillet të gjithë anëtarëve me një Vendim Qarkullues me qëllim miratimin apo jo të projektit.
3. **Miratohet:** Projekt mbulimi dhe restaurimi i mozaikut dhe rrethimi i bazilikës së Arapajt, Durrës me vërejtjet:
 - Të plotësohet itinerari i lëvizjes brenda kishës
 - Të bashkëpunohet me Kishën për hartimin e projektit të kapelës.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi i teqes së Backës komuna, Potom, Skrapar me vërejtjen:
 - Të ndahet preventivi në dy faza: faza e ndërhyrjeve emergjente dhe faza e ndërhyrjeve në prespektivë.

5. **Lidhur me:** Projekt propozim për rivitalizim dhe konservim të zonës historike Kalaja e Ndroqit, Tiranë, **Miratohen parimet kryesore të projekt - idesë:**
 - **Materiali i përdorur duhet të jetë reversibël.**
 - **Lartësia e objektit të mos kalojë 3-3.5m.**
 - **Të hartohet projekti i plotë dhe të diskutohet pranë KSH të IMK.**
6. **Miratohet:** Projekt restaurimi i shkollës mësonjëtorja e vjetër në fshatin Labova e Zhapës, Gjirokastrë.
7. **Nuk miratohet:** Projekt restaurimi i banesës individuale 2 katëshe, me pronar Rajmonda dhe Gjergji Trebicka, lagja 3, rruga Jeronim De Rada, nr. 7, Korçë. **Të reflektohen vërejtjet e sugjeruara nga Këshilli Shkencor i IMK.**
8. Pikat e tjera të rendit të ditës, dotë diskutohen në mbledhjen e ardhshme.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

FERDINAND XHAFERAJ

SEKRETAR I KKR

AKADEMIK. APOLLON BAÇE